



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 152, Datë 18.09.2020

MBI

**ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS  
SË SHOQËRISË “MOBIGAS ALBA” SH.P.K., PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË).**

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, nenit 91 dhe 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 15 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.09.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 102/5 Prot, datë 11.09.2020, të përgatitur nga Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 96, datë 08.06.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 62/16 prot, datë 10.06.2020, ka kryer njoftimin në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “MobiGas Alba” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.
- Me shkresën nr. 723/3 prot, datë 19.06.2020, ERE ka përcjellë pranë shoqërisë njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim të dokumentacionit të munguar apo atij të konsideruar si i nevojshëm/shtesë në kuadër të aplikimit.
- Dokumentacioni, i cili u konstatua në mungesë apo për plotësim, konsiston si vijon:

**Neni 9, pika 1. Forma e aplikimit**

- i) (Vërtetim nga organet kompetente që ndaj personit juridik apo personave dhe drejtuesve kryesore të shoqërisë tregtare që nuk ka një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale).

- xi) Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qera ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për Aplikantin për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën Licensën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisor sipas rastit për aktivitetet ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse.

### **Gërma “e” Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale**

- ii) Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tre viteve të fundit që paraprijnë paraqitjen e Aplikimit.
- vi) Një plan biznesi i cili përfshin një analizë të kostove dhe përfitimeve përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve).

### **2. Dokumente Specifike për Llojin e Licencës**

Licenca për tregtimin e Gazit Natyror: Duhet të përmbajë Informacion të përgjithshëm që përfshin:

- ii. Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të Sistemit.
- iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej Licencës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit.
- Pas depozitimit të dokumentacionit nga ana e shoqërisë, përkatësisht me shkresat nr. e protokolluara në ERE me nr. 723/7 prot., datë 13.07.2020, nr. 723/8 prot., datë 17.07.2020, nr. 697/17 prot., datë 24.07.2020, si dhe nr. 723/10 prot., datë 12.08.2020, ka rezultuar se ka mbetur ende dokumentacion/informacion pa plotësuar, si vijon:
  - **gërma “d”** (Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor)

vi. Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qera ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për Aplikantin për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën Licensën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisor sipas rastit për aktivitetet ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse. Plotësuar pjesërisht.
  - **gërma “e”**. Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale

ii) Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tre viteve të fundit që paraprijnë paraqitjen e Aplikimit. Plotësuar pjesërisht.

vi) Një plan biznesi i cili përfshin një analizë të kostove dhe përfitimeve përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve. Plotësuar pjesërisht.
  - **Dokumente Specifike për Llojin e Licencës**

ii. Garancinë që cilësia e tregtimit të gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të Sistemit. Pa plotësuar.

iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej Licencës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit. Plotësuar pjesërisht.
  - Edhe pse shoqëria ka depozituar dokumentacion e informacion për çdo kërkesë të rregullores, rezulton që dokumentacioni nuk është ende i plotësuar tërësisht sipas kërkesave specifike të

“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- Megjithëse shoqëria ka treguar vullnetin dhe angazhimin saj për të plotësuar çdo kërkesë të rregullores, është e nevojshme më shumë kohë, për vijimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kesaj kërkesë si dhe vlerësimin e kompetencës lëndore të ERE mbi këtë kërkesë.
- Në mbështetje të nenit 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ERE ka kompetencën të shqyrtojë dhe të shprehet në lidhje me kërkesën për shtytjen e afatit të një procedure nën autoritetin e saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes finale për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10-vjeçar.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**